REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 139
Datë/Datum 06.11.2015
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

**Datë: 05.11.2015**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.10.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1198, të datës 21.10.2015, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 7 të Ligjit për Policinë Nr. 04/L-076, (Gazeta Zyrtare Nr. 04/2012), Nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 4, paragrafi 1, pika 1.10 të Udhëzimit Administrativ, Nr. 27/2012 të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Nr. 03/2012 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

VENDIM

1. Për plotësimin e pikës 2 të Vendimit Nr. 25, të datës 06.03.2014, lidhur me përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, me përfaqësues të Komiteteve Lokale për Siguri Publike, për lagjen 'Qendër' dhe lagjen 'Dardania', të Fushë-Kosovës.

2. Anëtar i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, nga lagjja 'Qendër', e Fushë-Kosovës caktohet, Bahri Bislimi me vendbanim në Fushë-Kosovë.

3. Anëtare e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, nga lagjja 'Dardania', e Fushë-Kosovës caktohet, Adelina Avdyli me vendbanim në Fushë-Kosovë.

4. Ky vendim hyn në fuqi, ditë e aprovimit, nga Kuvendi Komunës dhe është pjesë e vendimit Nr. 25, të datës 06.03.2014.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Anëtarëve të KKSB-së dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Mr. Fadil Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS - SKUPŠTINA OPŠTINE
FUSHË-KOSOVË KOSOVO POLJE